

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Maqedonia e Veriut te Kroacia, Vuçiq i shënjestron të tërë, komenton reagimet e Ramës, Begajt dhe liderëve të rajonit - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/nga-maqedonia-e-veriut-te-kroacia-vucic-i-shenjestrone-tere-komenton-reagimet-e-rames-begajt-dhe-lidereve-te-rajonit/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 20:21:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 20:13:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3fcad03e2acd4855d2ce7e22c77d6991c69187d38a285b7184b209bc366c95e2
TEKSTI	b89f8b2ba0c039d071d39bbcd5941ee45f3b3719be70fb3f3f47453aa9db19ec
PAMJA	fdc04556446d5bd2fc1f0d51e11921b3f49a766afc1f3589c0f3145ffaf9d491

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8b9a3d591f3875c69280b63a135ae95e728c41af8381f83ef008775d611d932e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f72115bb0c326093347f412235a8c378aab409f85fb276171d0e9653b9a6bcbd
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8b9a3d591f3875c69280b63a135ae95e728c41af8381f83ef008775d611d932e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Nga Maqedonia e Veriut te Kroacia, Vuçiç i shënjestron të tërë, komenton reagimet e Ramës, Begajt dhe liderëve të rajonit

LAJMET E FUNDIT

Demo

Nga Maqedonia e Veriut te Kroacia, Vuçiç i shënjestron të tërë, komenton reagimet e Ramës, Begajt dhe liderëve të rajonit

SEPTEMBER 16, 2026



Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka reaguar sërish pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj ish-drejtimesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të cilët u dënuan me një total prej 81 vitesh burgim për vepra penale që lidhen me arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe vrasjet e paligjshme.

Në një konferencë për mediat, Vuçiç u shpreh i pakënaqur me vendimin, duke argumentuar se, sipas tij, ish-krerët e UÇK-së nuk janë dënuar për krime ndaj njerëzimit.

Gjatë fjalës së tij, presidenti serb iu referua në mënyrë të detajuar reagimeve të zyrtarëve të lartë politikë nga rajoni pas shpalljes së aktgjykimit. Vuçiç tha se kishte planifikuar deklaratën e tij për në orën 18:30, në mënyrë që të priste reagimet e liderëve të ndryshëm përpara se të dilte publikisht.

Ai nisi me reagimin e Presidentit të Shqipërisë, Bajram Begaj, duke iu referuar deklaratës së tij në lidhje me vendimin e Hagës.

"Imagjinoni sikur një nga zyrtarët tanë të thoshte: 'Liria ka një emër' dhe të përmendte ndonjë serb të dënuar nga Tribunali i Hagës", tha Vuçiç.

Më tej, ai përmendi edhe reagimin e kryeministrit shqiptar, Edi Rama, i cili pas shpalljes së vendimit publikoi fjalën "turp" në rrjetet sociale.

Deklarata bëhet në minutën 11:24.

Presidenti serb iu referua edhe reagimeve nga Prishtina, duke cituar kryeministrin Albin Kurti, i cili e cilësoi aktgjykimin si "padrejtësi të papranueshme" dhe "dënim të rëndë", ndërsa deklaroi se vendimi duhet të ndryshohet gjatë procesit të apelit.

Një pjesë të veçantë të deklaratës së tij Vuçiç ia kushtoi zëvendëskryeministrit të Malit të Zi, Nik Gjeloshaj. Ky i fundit e kishte cilësuar vendimin e Hagës "jashtëzakonisht të padrejtë" dhe kishte deklaruar se "çdo shqiptar e mban në zemër luftën e shenjtë të UÇK-së". Gjeloshaj kishte shprehur gjithashtu bindjen se vendimi mund të ndryshohet në instancat më të larta gjyqësore.

Duke iu referuar kësaj deklarate, Vuçiç ngriti pyetjen nëse qëndrime të tilla mund të kenë pasoja në procesin e integritetit evropian të Malit të Zi.

"A do ta ndalojnë integritetin evropian sepse e fyejnë vendimin, e mohojnë sundimin e ligjit? Apo kjo vlen vetëm për serbët?", pyeti presidenti serb.

Vuçiç përmendi gjithashtu reagimet e disa politikanëve shqiptarë në Maqedoninë e Veriut, mes tyre

Postimet e reja

Nga Maqedonia e Veriut te Kroacia, Vuçiç i...

SEPTEMBER 16, 2026

"Liria ka emër", Dua Lipa dhe Rita Ora në...

SEPTEMBER 16, 2026

Britania e Madhe pas vendimit të Hagës:...

SEPTEMBER 16, 2026

"Çdo shqiptar mban në zemër luftën e shenjtë t..."

SEPTEMBER 16, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematicët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

Bekim Sali, kryetari i Kuvendit Afrim Gashi dhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti. Ky i fundit e cilësoi vendimin e Hagës si të padrejtë dhe thellësisht zhgënjyes.

“Dhe unë mendova se ata janë kriminelë, të paktën të dënuar në shkallën e parë. Jo, të gjithë janë çlirimtarë, heronj dhe heroinat”, u shpreh Vuçiç, duke iu referuar reagimeve të zyrtarëve shqiptarë.

Në konferencën e tij, presidenti serb foli edhe për qëndrimin e diplomacisë kroate. Sipas Vuçiçit, Zagrebi, ndërsa deklaroi se “e merr në dijeni” vendimin e gjykatës, njëkohësisht theksoi qëndrimin e tij lidhur me kontekstin politik dhe historik të luftës në Kosovë.

Në përfundim, Vuçiç argumentoi se reagimet e ndryshme ndaj aktgjykimit tregojnë, sipas tij, ekzistencën e standardeve të ndryshme në trajtimin e serbëve dhe popujve të tjerë të ish-Jugosllavisë.

“Serbët duhet të jenë kriminelë në çdo njoftim, në çdo deklaratë”, deklaroi presidenti i Serbisë.

YouTube

TikTok

Vuçiç

SHARE.

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.